

**INSTITUTI I SHENDETIT
PUBLIK****DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE****BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)**

JANAR, 2025

Buletini Muja i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin janar 2025 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara dhe në disa raste edhe rastet e dyshuara dhe të konfirmuara.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit janar 2025 zënë 17.9 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 241.2/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 3.9/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin janar 2025 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin janar 2025 (Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste janar 2025	Incidenca janar 2025 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	3	0.10
Shigelozë (Disenteri bacilare)	1	0.03
Dizenteri amebike	0	0.00
Toksiko-infeksione alimentare	112	3.9
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	6789	237.2
Sëmundje diarreike në total	6905	241.2

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit janar 2025 janë raportuar në total 257 raste variçelë (incidenca 8.9/ 100.000 banorë) nga të cilat, 173 raste janë të dyshuara dhe 84 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen variçelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 79 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 114 raste, grafiku 1.

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës



2.2 Fruthi

Gjatë muajit janar janë raportuar 8 raste të dyshuar me fruth nga të cilët është konfirmuar (12.5%) 1 rast nga ana laboratorike si pozitiv me virusin e fruthit. Incidenca e fruthit për muajin janar është 0.04 raste/ 100000 banorë.

Rasti i përket moshës 1 vjeç, gjinisë mashkull, banor i bashkisë Shkodër. Pacienti ka shfaqur shenja klinike të fruthit dhe ka qenë i shtruar në spital, është i vaksinuar vetëm me një dozë të vaksinës FRP sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit (SIV). Nga ana e shërbimit epidemiologjik është kryer hetimi në vatër për rastin dhe janë marrë masat e kontrollit për ndërprerjen e transmetimit të virusit.

3. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit janar 2025 janë raportuar gjithsej 20 raste me turbekuloz (TB). Prej të cilave 14 raste janë pulmonare dhe 6 raste ekstrapulmonare.

Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv.

Rastet pulmonare përkatësisht janë: 5 në Tiranë, 1 në Berat, 1 në Bulqizë, 2 në Korçë, 1 në Krujë, 2 në Lezhë, 1 në Shkodër dhe 1 në Mat.

Ekstrapulmonare përkatësisht janë 6 raste: 2 në Tiranë, 1 në Dibër, 2 në Lushnje dhe 1 në Lezhë.

Raste recidive për muajin tetor është 1 në Lezhë.

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me numrin më të madh me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë

4. Sëmundjet zoonotike

Tabela 2: Shpërndarja e zoonozave në muajin janar 2025, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciozë)

	Janar (raste 2025)	Incidenca (raste/100,000) 2025
--	--------------------	--------------------------------

Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	5	0.17
Leptospirozë	1	0.03


Për muajin janar janë raportuar 5 raste Bruceloze përkatësisht: 1 në Kolonjë, 2 në Kukës, 1 në Dibër dhe 1 në Gjirokastrë. Gjithashtu, është raportuar edhe 1 rast i konfirmuar me Leptospirozë nga Librazhdi.

5. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

COVID-19

Gjatë muajit janar 2025 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 7 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin janar është 0.25 raste /100000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave




Grup-moshat më të prekura për këtë muaj janë grup-mosha 0-4 vjeç, 25-34 vjeç, 35-44 vjeç dhe 55-64 vjeç.

Rastet janë raportuar nga bashkia Tiranë. Gjatë muajit janar 2025 është raportuar 1 rast i shtruar në spital dhe asnjë raste vdekjeje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 14% (1 rast) në ISHP dhe 86% (6 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve.

Grip

Gjatë muajit janar janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 775 raste të konfirmuara me Grip, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin janar është 27.1 raste /100000 banorë. Grafiku 7 tregon shpërndarjen e rasteve sipas tipit të viruseve qarkullues. Vërehet mbizoterim i Gripit Tipi A.

Grafiku 3. Tipi i viruseve qarkulluese



Në muajin janar qarkullimi i gripit arriti intensitet mesatar duke paraqitur aktivitet sezonal normal të zakonshëm dhe të pritshëm për stinën, dhe përhapje gjeografike rajonale. Raste me grip u identifikuan si nga survejanca sentinel ILI-SARI, ashtu edhe nga survejanca virologjike josentinel.

6. Sëmundje të tjera

6.1 Leshmanioza Viscerale

Gjatë muajit janar 2025 është raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 2 raste të konfirmuara me Leshmanioza Viscerale nga Elbasani.